VENDIM
Nr.286, datë 6.4.2011

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "HËNA E PLOTË" (BEDËR), TIRANË

(Ndryshuar me VKM nr. 571, datë 24.6.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44, 44/1 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private "Hëna e plotë" (Bedër), e cila ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

Leja për hapjen e kësaj shkolle i jepet "Komunitetit Mysliman Shqiptar".

2. Shkolla e lartë private "Hëna e plotë" (Bedër) organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Shkencave Humane, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

i) Drejtësi (3 vite akademike);

ii) Shkenca komunikimi (3 vite akademike);

iii) Shkenca islame (3 vite akademike),

b) Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, me programin e studimit, në formën e studimit me kohë të plotë:

Gjuhë dhe letërsi turke (3 vite akademike).

3. Shkolla e lartë private "Hëna e plotë" (Bedër) do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale prej 3 (tre) vitesh akademike, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në fushat e mëposhtme:

i) Drejtësi;

ii) Shkenca komunikimi;

iii) Shkenca islame;

iv) Gjuhë dhe letërsi turke.

4. Shkolla e lartë private "Hëna e plotë" (Bedër), Tiranë, fillon veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se 3 (tri) javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Ndryshimet në vendndodhje, staf pedagogjik, plane dhe programe mësimore, forma studimi dhe programe, si dhe të elemente të tjera, të bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë private "Hëna e plotë" (Bedër), Tiranë, duhet t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit dhe akreditimit institucional e të programeve të studimit, si dhe të zbatimit të ligjshmërisë në institucion.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shkolla e lartë private "Hëna e plotë" (Bedër) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha